

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-92/2014

Prishtinë,
17 shtator 2014

Në çështjen juridike të:

S. Č.

Prishtinë

Pala ankuese

kundër

N/A

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC /D/C/224/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA10261), pas shqyrtimit të mbajtur më 19 shtator 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e S. Č. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/224/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA10261) të datës 27 nëntor 2013.
2. Vërtetohet vendimi i KPCC/D/C/224/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA10261) i datës 27 nëntor 2013.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 22 janar 1007 S.Č. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkonte vërtetim pronësie lidhur me garazhën nr. G-14 në Rrugën e Sremit, Lamela II, sipërfaqja 19m², në Prishtinë. Ajo ka theksuar se data e humbjes ishte me 1 qershor 1999.
2. Më 7 gusht 2007, AKP-ja kishte bërë njoftimin e kërkesës në lidhje me pronën e kërkuar.
3. Ndaj kërkesës nuk kishte pasur asnjë përgjigje.
4. Më 27 nëntor 2013 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) e kishte hedhur poshtë kërkesën. KKPK kishte konstatuar se kërkesa nuk ishte e ndërlidhur me konfliktin e armatosur në Kosovë në vitet 1998/1999, prandaj kërkesa ishte hedhë për shkak të mungesës së jurisdiksionit.
5. Vendimi i ishte dorëzuar S. Č. me datën 5 mars 2014. Ajo kishte paraqitur një ankesë kundër vendimit me datën 21 mars 2014. Gjykata Supreme e kishte marrë lëndën me datën 23 qershor 2014.

Pretendimet e palës ankuese

6. S.Č. pretendon se ajo e kishte dëshmuar se ajo e kishte blerë pronën dhe se e kishte humbur atë për shkak të konfliktit të armatosur në Kosovë gjatë viteve 1998/1999. Për shkak të kësaj, njerëz

të tjerë e kanë zënë pronën e saj. KKPK gabimisht ka konstatuar se Č. nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme. Ajo e ka dëshmuar pronësinë përmes kontratës së blerjes dhe faturave. Është mirë e ditur se shqiptarët kanë humbur posedimin e pronave të tyre në fazën fillestare të luftës dhe serbët kanë humbur pronat e tyre pas luftës. Këto janë fakte të ditura që nuk kërkojnë prova.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

7. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur mbrenda afatit kohor prej 30 ditësh ashtu siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit Nr. 03/L-079.

Meritat e ankesës

8. Sipas “Kontratës për ndërtimin e garazheve” të datës 4 maj 1995 të lidhur në mes të Ndërmarrjes Publike Banësore dhe S. Č. më 4 maj 1995, Č. ka blerë garazhën e kontestuar. Çmimi i blerjes ishte 11 343 Dinarë. Sipas kontratës në fjalë, neni 5, rrjedh se 50 % e çmimit të blerjes është dashur të paguhet pas nënshkrimit të kontratës ndërsa pjesa tjetër në këste në përputhje me dinamikën e ndërtimit të garazhës dhe faturat e dorëzuara.
9. Sipas raportit të verifikimit të datës 12 prill 2007 z. R.D., zyrtar i Ndërmarrjes Publike ka thënë se këto garazha nuk ishin përfunduar akoma dhe se pjesa e dytë e pagesës do i ngarkohej S. Č-it kur ndërtimi i tyre do të përfundonte. Sipas raportit të verifikimit të datës 12 shtator 2013, z. J. G., zyrtar i Ndërmarrjes Publike Banësore, ka theksuar se znj. Č. nuk i ka shlyer detyrimet e saja në tërësi ndaj shitësit.
10. KKPK ka theksuar se Č. ishte kontaktuar nga AKP-ja me datën 30 shtator 2013 dhe se ajo e kishte konfirmuar se nuk e kishte posedimin mbi garazhën gjatë viteve 1998/1999, pasi që objektet nuk ishin përfunduar deri atëherë.
11. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Patundshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079), KKPK ka kompetencë të zgjidh kërkesat që ndërlidhen me konfliktin që kanë të bëjnë me pronësinë apo të drejtat pronësore mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale. KKPK është

kompetent vetëm nëse kërkesat kanë të bëjnë drejtpërdrejtë ose që rrjedhin nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në periudhën prej 27 shkurt 1998 deri më 20 qershor 1999.

12. Në rastin aktual S. Č. vet ka theksuar që ajo asnjëherë nuk e ka pasë në posedim garazhen as para dhe as gjatë konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në periudhën 1998/1999. Rrjedhimisht, lënda bie jashtë juridiksionit të KPPK-së. Prandaj, ankesa duhet të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi i KPPK-së.
13. Arsytet e dhëna nga ana e ankuesit për sa i takon meritave të kërkesës nuk janë shqyrtuar nga ana e Kolegjit meqë ato nuk janë relevante për këtë lëndë. Çdo kontest në mes të S. Č. dhe shitësit të garazhës duhet të zgjidhet nga gjykatat e zakonshme të Kosovës.
14. Nga ajo që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Esmā Erterzi, Kryetare e Kolegjit nga EULEX-i

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it